

## PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

Viti shkollor 2014/2015

# TESTI GJUHË SHQIPE

### UDHËZIM PËR PUNË

- Testi përmban **20** detyra të cilat duhet t'i zgjidhësh për **120** minuta.
- Secilën detyrë lexoje me kujdes, mendo mirë se çfarë kërkohet në detyrë dhe për mënyrën sipas së cilës duhet ta zgjidhësh (duke e rrethuar, bashkuar, nënvizuar, plotësuar e të tjera).
- Shkruaj shkronjat qartë, duke pasur parasysh që përgjigjet e tua të jenë të kuptueshme, por edhe të sakta në kuptimin gramatikor dhe drejtshkrimor.
- Me rastin e zgjidhjes së detyrave në të cilat prej teje pritet që të plotësosh ndonjë gjë, gjithnjë duhet t'i përdorësh emërtimet e plota; shkurtesat nuk lejohen (psh., duhet të shkruhen emrat, e jo em. ose kallëzorja e jo kall., dhe të ngjashme).
- Plotësoje testin me **stilolaps** (gjatë zgjidhjes së detyrës duhet të përdorësh lapsin e thjeshtë dhe gomën).
- Përgjigjeve të shkruara me stilolaps nuk mund t'u biesh vizë ose t'i korrigjosh.
- Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps të thjeshtë nuk do të pranohet.
- Në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës mos shkruaj asgjë. Kjo është hapësirë në të cilën kontrolluesi do t'i shënojë pikat. Në këtë dhe në faqen e fundit gjithashtu nuk mund të shkruash asgjë.
- Nëse e mbaron më herët, dorëzoje testin dhe ngadalë dil jashtë që të mos e pengosh punën e të tjerëve.

**Të dëshirojmë sukses në punë!**

## 1. Shqiponja, sorra dhe bariu

Një shqiponjë shigjetoj me vrull nga një shkëmb i lartë dhe rrëmbeu një qengj. Një sorrë që e pa, plasi nga zilia dhe deshi të bënte edhe ajo të njëjtën gjë. U ul me zhurmë dhe qëndroi mbi një dash. Po iu pleksën thonjte në leshin e dashit, e nuk mundi të ngrihej. Rrahu ajrin me krahë me forcë, sa e pikasi bariu, i cili i shkoi pranë, e zuri dhe i preu ca pendë. Në mbrëmje e mori me vete dhe ua shpuri fëmijëve.

Kur ata e pyeten se ç'lloj zogu ishte ky, ai iu përgjigj:

- Është një sorrë, që e mban veten për shqiponje. (Ezopi)

Lexo tregimin e dhënë dhe thuaj se tregimet (Krijimet) e këtilla popullore ku si personazhe kryesore kemi kafshët, shpezët apo edhe insektet, e në të cilat alegoria është figura kryesore quhen:

- a) Përralla
- b) Anegdota
- c) Fabula
- d) Përrallëza ?

## 2.

### Bora

Kthjelltësia a qiellit shkoi me diellin, me lulet, me verën. Vjeshta e trishtueshme erdhi dhe iku. Tani po hyn dimri edhe qiellin e kanë mbuluar re të qeta e të ftohta. Edhe sot, për të parën herë, zu të bjerë bora.

Prapa qelqeve të dritares po shikoj. Ngadalë, ngadalë, sikur ka frikë të dëgjohet, bora fluturon flokë-flokë, e shtrohet mbi dhe. Bie kudo, e duket sikur kërkon të ndreqë e të zbukurojë. Dy cupa të vockëla shkojnë, e, në leshërat e tyre të arta, të lëshuara mbi shpatulla, bora shkruan trëndafile të argjendta. Djemtë qeshin, hidhen, luajnë e luftojnë me topa. Zogjtë rreth e rrotull parqeve, ciu, ciu, një thërrime buke!

Si në verë, gjithë bota është veshur në të bardha.

Flokë-flokë, ngadalë po bie bora ... Faik Konica Bora“

Lexo tekstin e dhënë dhe trego cilit lloj të stilit i përkasin mjetet gjuhësore të përdorura nga autori:

- a) stilit letrar - artistik;
- b) stilit shkencor;
- c) stilit gazetaresk;
- d) stilit letrar.

**3.** Lexo fragmentin e dhënë më poshtë dhe qarko përgjigjen e saktë.

GDHENDËSIT

Pak rëndësi kishte se ç' mendonin të tjerët, Abuja dhe Koni ishin miq. Por këtë miqësi të gjithë fqinjët e kishin të vështirë ta besonin, sepse të dy druvarët ishin jashtëzakonisht të ndryshëm nganjëri- tjetri. Ishte e sigurt se, nëse Abuja i thoshte Konit se stina e shirave do të fillonte së shpejti, Koni do të parashikonte thatësi të menjëhershme dhe të ashpër. Ose, nëse Koni provonte një frutë dhe thoshte se kishte shije të mrekullueshme, Abuja ngulte këmbë duke thënë se nuk futej në gojë, aq i hidhur ishte. Gjithçka që planifikonte Koni, Abuja do ta kundërshtonte; çdo mendim që të shprehte njëri, tjetri do t'i dilte medoemos kundër. Të paktën kështu iu dukej banorëve të fshatit që ndodhej në një lirishtë, pranë një pylli të madh.

Qëllimi kryesor i paragrafit të parë të kësaj historie është:

- a) të përshkruajë ndodhinë;
- b) të prezantojë temën;
- c) të paraqesë personazhet;
- d) të na njohë me autorin.



**4.** 16 mars 1923

I dashur Mik, °

Ju falemnderit për fjalët e bukura me të cilën më mprojtët në "Parlament": është një fjalë klasike nga forma dhe nga brenda e përmbledhur.

Më vjen keq për mjerimin që i çkuli nga vatrat e tyre motrat tuaja dhe vëllanë. Më duket se më e mira është të vijnë në Shqipëri, se edhe në u ktheshin në Thrakë, s'ka dyshim se pas ca kohe do t'shtrëngohen prapë të çvendosen.

Një shqiptar i mirë nga të Bostonit dëshëron të sjellë në Amerikë t'anë At Vangjel Lubonjën, që ron tani në Korçë. Që të mos gjejë pengime nga Immigration Office-i ju lutem t'i jipni një porosi inglisht nga ana juaj, që të hyjë këtu si misionar. Jam i bindur që jo vetëm nuk do të pendoheni, po mund të dilni edhe i fituar, se padyshim At Vangjel Lubonja do t'përkrahë lëvizjen kishtarë t'uaj në Amerikë. Kthehem përsëri në punë të vëllait dhe motrave t'uaja. Rizgjedhja ime si kryetar i "Vatrës" duket e siguruar, dhe do të bëj të pamundurën që të ju votohet përsëri një shumë për vitin 1923-4.

Juaji me besë Faik Konitza

Lexo pjesën e dhënë dhe trego cilit lloj të komunikimit i takon? Rretho përgjigjen e saktë:

- a) Letër personale;
- b) Letër zyrtare;



5. Pranë vizave shkruaj fjalët e mëposhtme sipas gjuhës letrare:

Voj \_\_\_\_\_; Votër \_\_\_\_\_; Rana \_\_\_\_\_;  
Syni \_\_\_\_\_; Hana \_\_\_\_\_;

6. Lexo fjalitë e dhëna më poshtë dhe duke e rrethuar shkronjën para përgjigjes së saktë trego se cila prej fjalive të dhëna është shkruar sipas rregullave drejtshkrimore?

a) Futbollistat stërviten shumë. \_\_\_\_\_

b) Shitorja ishte plot mallra. \_\_\_\_\_

c) Sa më pëlqen të lundroj në detërat. \_\_\_\_\_

7. Në vijën pas fjalëve shkruaj, cila është fonema që e kanë të gjitha këto fjalë

thupra \_\_\_\_\_

thika \_\_\_\_\_

thembra \_\_\_\_\_

8. Cilat janë dy fonemat që shërbejnë për të dalluar fjalët e mëposhtme të shënuara dhe trego se çfarë fonemash janë: zanore apo bashkëtingëllore?

shpullë – pullë: \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_.

Arë – erë: \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_.

Gurë – turrë: \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_.

palë – pulë: \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_.

miell – diell: \_\_\_\_\_, \_\_\_\_\_.

**9.** Lexo fjalitë e dhëna dhe nënvizo foljen kallëzues tek fjalia e parë, kurse te fjalia e dytë nënvizo emrin kryefjalë.

1. Goni dëgjon cicërimat e zogut.

2. Zogu ishte i tërbuar.

**10.** Emrat janë fjalë të ndryshueshme të ligjëratës që tregojnë:

a) Veprime;

b) Frymorë, vende apo sende;

c) Cilësi;

d) Kafshë;

**11.** Në vijën përballë fjalëve të dhëna shkruaj bashkëtingëlloret e zëshme:

Dogja \_\_\_\_\_

Hudhër \_\_\_\_\_

Guri \_\_\_\_\_

**12.** Në vijë përballë mënyrave të foljes shkruaj mënyrat e foljes:

a) të shtjelluara: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

b) të pashtjelluara \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**13.** Gjeni rrënjën dhe parashtesën në fjalët e dhëna:

përfill (rrënja) \_\_\_\_\_ (parashtesa) \_\_\_\_\_

përlotë (rrënja) \_\_\_\_\_ (parashtesa) \_\_\_\_\_

përhapë (rrënja) \_\_\_\_\_ (parashtesa) \_\_\_\_\_

**14.** Trego cilës klasë gramatikore i takojnë fjalët e dhëna më poshtë:

a) filloj;

b) nesër;

c) libër;

ç) i bukur.

**15.** Cilët janë poetët e poezive të mëposhtme? Lidh me shigjetë poezinë me emrin e poetit.

1. Bota fëmijërore

Migjeni

2. Lejleku

Naim Frashëri

3. Mejtimi

Dritëro Agolli

4. Dhe pranvera erdhi

Adem Gajtani

**16.** Përballë titullit të veprave vendos numrin që gjendet para emrit të autorit.

1. Lulet e verës -----/ / Sofokliu;

2. Shpella e piratëve -----/ / Ndre Mjedja;

3. Kështjella -----/ / Naim Frashëri;

4. Andrra e jetës -----/ / Petro Marko;

5. Antigona -----/ / Ismail Kadare

**17.** Lexo me kujdes vargjet e poezisë “Gjuha shqype” të Gjergj Fishtës dhe trego cilës gjini letrare i takon ajo:

Porsi kanga e zogut t'verës,  
qi vallzon n'blerim të prillit;  
porsi i ambli fladi i erës,  
qi lmon gjit e drandofillit;

Porsi vala e bregut t'detit,  
porsi gjâma e rrfës zhgjetare,  
porsi ushtima e nji tërmetit,  
ngjashtu â' gjuha e jonë shqyptare.

Ah! po; â' e ambël fjala e sajë,  
porsi gjumi m'nji kërthi,  
porsi drita plot uzdajë,  
porsi gazi i pamashtri;

Edhë ndihet tue kumbue;  
porsi fleta e Kerubinit,  
ka'i bien qiellvet tue flutruë  
n't'zjarrtat valle t'amëshimit.

Pra, mallkue njai bir Shqyptari,  
qi këtë gjuhë të Perëndis',  
trashigim, që na la i Pari,  
trashigim s'ia len ai fmis;

Edhe atij iu thaftë, po, goja,  
që përbuzë këtë gjuhë hyjnore;  
qi ngjuhë t'huej, kur s'asht nevoja,  
flet e t'veten e lën mbas dore.

a) poezisë lirike;

b) poezisë epike;

c) poezisë dramatike;

Rretho shkronjën para përgjigjes se sakte.



## 18. SHKËMBI I SKËNDERBEUT

Skënderbeu ishte me një fuqi të vogël në Rrajcë.

Turqit, me një fuqi me të madhe, po i vinin nga lindja.

Skënderbeu donte me u dalë në ballë por i kishte prerë rrugën një shkëmb.

Ai nxjerr shpatën dhe e ndan shkëmbin në dy pjesë, pastaj u bie dhe turqve e i prishi krejt. Shkëmbi duket sikur është prerë sot dhe quhet SHKËMBI I SKËNDERBEUT.

Lexo fragmentin e dhënë dhe trego se ky tekst është?

- a) monolog;
- b) dialog;
- c) përshkrim;
- d) legjendë.

## 19. Besa e Kostandinit

Gjashtë e gjashtë dymbëdhjetë, Doruntina trembëdhjetë !...

Ish njëherë e një mot një nënë shumë e mirë i kish dymbëdhjetë bij të hijshëm. Të trembëdhjetën kishte një bijë të bukur mbi shoqet të gjitha, që ia thoshin Doruntinë .

Vasha u rrit e u bë për tu martuar. Mirëpo nga bujarët e atij vendi askush nuk e gëzoi. Të gjithë e dëshironin askush s'guxonte ta zërë nuse, sepse nuk e ndjente veten të zotin për ta marrë për shoqe. Atëherë na vjen një trim i largët; i mirë, i hijshëm, i fisëm dhe nis dërgon shkesë dallëndyshen që ta kërkojë Doruntinën nuse. E ëma dhe të njëmbëdhjetë vëllezërit e mëdhenj nuk donin t'ia jepnin, sepse trimi ndonëse i mirë e i fisëm, ishte nga një vend shumë i largët. Vetëm i vogli, Kostandini donte.

- T'ia japim zonja mëmë - thosh ai - se trimi është i mirë. Më ka hyrë në zemër.

- Kostandin biri im, çfarë po thua ti kështu? - ia kthente e ëma. Aq larg do ma shpiësh Doruntinën time? Se në e daça për gëzim, për gëzim nuk do ta kem; se në e daça për helm, për helm nuk do t'a kem.

- Të jap besën zonja mëmë, se kur t'a duash ti Doruntinën, qoftë për gaz qoftë për helm, vete unë e t'a sjell!

Mëma dhe të njëmbëdhjetë vëllezërit u bindën: e vluan dhe e martuan Doruntinën me trimin e largët. Bënë dasmë nëntë ditë. Të dhjetën trimi mori nusen e shkoi tek dheu i tij i largët. Mëma e vasha qanë me lot kur u ndanë ...

Lexo fragmentin e dhënë dhe trego nëse teksti është:

- a) tregim;
- b) ritregim;
- c) analizë;



## 20. Ëndërr e Prerë

Mos vdis, se pas shirave arën e mbushi bari,  
Ka rënë në ullishtë mizë e ullirit.  
Hardhia duhet spërkatur shpejt me gurrkali  
Dhe ende s'ka dalë nga plisi kërcelli i misrit

Ne ëndërronim të bënim një anije,  
Kurkush s'e mendonte më ç'dru do ta ngrinim,  
Kishim ndërmend ta ndërtonim me degë hardhie  
Dhe vela ti vinim.

Bodrumet e saj t'i mbushnim me poçe me verë  
Dhe të lundronim në ishujt e Havajës;  
Ta pinim verën me vajzat e ishujve në Belvedere,  
Zezaku të bënte fresk me fletën e palmës.

Mos vdis se kalit i ra në vrapim një patkua  
Dhe nisi ta ngrejë nga dhimbja këmbën e parë;  
Kërkojmë patkonj e s'na jep njeri hua,  
Së gjejmë as nallbanin e marrë.

Lexo këtë poezi të Dritëro Agollit dhe trego llojin e rimës të cilën e ka përdorur autori:

- a) aabb;
- b) abab;
- c) baba;
- d) baba.

